



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep Dop Dep	Nr Prot B: Prot Prot No
Nr. Titu Shoq. stranca	Data Datum
Nr. pages	
PRISHTINE	

DPK 02 03-02/3144/17 09.10.2017



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.10.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2533-17, për Zyrtarin e lartë z.Naim Sahiti – Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Pejës, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-2533/17, për Zyrtarin e lartë, z.Naim Sahiti – Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Pejës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit ka bërë shkresë njoftuese zyrtarit të lartë z.Sahiti (DPK-03-02-2533-17), dhe pastaj ai ka kontaktuar Agjencinë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Sahiti është deklaruar se ai praktikisht vetëm ka konkurruar për të qenë Anëtar i Bordit të Kompanisë së Sigurimeve “Elsig”, por praktikisht nuk është pranuar në këtë pozitë dhe rrjedhimisht as nuk e ka ushtruar në praktikë.

Fakti se figuron emri i tij te personat e autorizuar të këtij biznesi në të dhënat e ARBK-së, sipas deklarimeve të z.Sahiti, ka qenë i panjohur edhe për te deri në momentin e shkresës zyrtare dhe sqarimit nga Agjencia kundër Korrupsionit.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar ndryshimet në biznesin Kompania e Sigurimeve “ELSIG” Sh.A. (DPK/Dpki-03-02/3061/17) të bëra në Agjencionin për Regjistrimin



e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilin shihet se, z.Naim Sahiti tashmë nuk është pjese a asnjë funksioni në këtë biznes privat, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtore Agjencisë kundër Korrupsionit


/ Shaip Havolli /

